




Për :Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: z.Ekrem Kastrati, Kryetar i Komunës



PRANUAR ME:

ACCEPTED ON: 16/10/2024

PRIMIENO

No. No. Br. 01/1092

**RAPORT PERIODIK PËR ZBATIMIN E
REKOMANDIMEVE**

**të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra
Kombëtare e Auditimit**

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin e rekomandimit	Statusi i rekomandimit (i zbatuar, pjesërisht i zbatuar ose i pa zbatuar)	Sfidat e hasura në zbatimin e rekomandimit
1	Çështja A1 Nënvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	Rregullorja MF - nr.01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore, përkatësisht neni 16 përcakton se: Organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave. Komuna ka bërë një raportim jo të plotë dhe jo të saktë të llogarive të arkëtueshme në PVF, duke nënvlerësuar llogaritë e arkëtueshme për 862,528€. Nënvlerësim ka ndodhur si rezultat mos	Kryetari duhet të forcojë kontrollet dhe të përmirësojë proceset e regjistrimit dhe raportimit financiar për të siguruar që LI/A në PVF të jenë të plota dhe të sakta.	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në rritjen e kontrollit të brendshëm duke kompletuar stafin dhe ngritur performancën në raportimin e llogarive të arkëtueshme.	I zbatuar	Mosbarazimi i llogarive të arkëtueshme nga viti i kaluar ishte rezultat i një gabimi teknik.

		nxjerrjes së shënimeve nga Protax për shumat e faturuar dhe të painkasuara për tatimin në pronë të tokave dhe parcelave për periudhën 2019-2023. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos funksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme në raportimin e LI/A.				
2	Çështja B1 Nënvlersimi i pasurive jo kapitale	Rregullorja Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat, Buxhetore neni 6 parasheh se: "Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare. Lidhur me këtë kemi konstatuar se: Pasuritë jo kapitale nën 1000€, të blera gjatë vitit 2023 në vlerë 240,605€, nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasurive ose në ndonjë formë tjetër alternative si dhe nuk janë prezantuar në PVF. Vlera e pasurisë jo kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë jo financiare të komunës, janë të plota dhe të sakta në regjistrat përkatës të pasurive jo financiare dhe PVF.	Janë ndermarr veprimet e duhura duke caktuar zyrtarin për pasuritë jokapitale(e-pasuri) dhe funksionalizimi i zyrtarëve të logjistikës.	Pjesërisht i zbatuar (në proces)	

		prezantuar në PVF ishte bartur nga vlera e pasurisë së raportuar nga viti paraprak, e cila ishte 208,782€. Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së mjaftueshme të kontrolleve të brendshme ndaj menaxhimit të pasurive jo financiare.				
3	Çështja B2 Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve	Rregulla financiare nr. 01/2013/MF "Mbi shpenzimin e parasë publike", neni 18 pika 3 specifikon se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Rrjedhimisht, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël, kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA. Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 170,050€ në kategori jo adekuate: • Nga	Kryetari duhet të sigurojë që planifikimi buxhetor i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive adekuate si dhe pagesat të regjistrohen në kode përkatëse ekonomike në përputhje me planin kontabël të aprovuar nga Thesari.	Janë ndermarr veprime të nevojshme nga zyrtarët kompetent, gjatë këtij viti duke mos lejuar keqklasifikim të shpenzimeve nga kategoritë e ndryshme. Ekzekutimi i vendimeve gjyqesore nuk varet nga vendimmarrja komunale.	I zbatuar	

		kategoria e investimeve kapitale janë paguar për paga dhe mëditje/shujta në vlerë prej 65,000€ (vendimeve gjyqësore) ; • Nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve janë paguar për paga dhe mëditje/shujta në vlerë prej 40,050€ (vendimeve gjyqësore); dhe • Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve janë paguar për pajisje mjekësore në vlerë prej 65,000€ (pasuri mbi 1000€) për nga natyra i takojnë investimeve kapitale. Pagesat për paga jubilarë dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet.				
4	Çështja A2 Inicimi i procedurave të prokurimit pa fonde të mjaftueshme	Ligjit nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 36, paragrafi 1 përcakton se "Para inicimit të një procesi të prokurimit i cili ka për qëllim të	Kryetari duhet të forcojë kontrollet gjatë vlerësimit të projekteve, duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit për çdo projekt kapital të	Nuk është ndermarr ndonjë veprim rreth këtij rekomandimi.	I pa zbatuar	

		rezultojë në ngritjen e një obligimi në vitin fiskal, Organizata Buxhetore i regjistron të gjitha zotimet e fondeve të ndara në Sistemin Informativ për Menaxhimin Financiar në Kosovë në përputhje me Rregullen Financiare nr.01/2013. Gjatë testimeve, kemi vërejtur se në pesë (5) raste, komuna kishte hyrë në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme. Rastet si në vijim: • Projekti "Ndërtimi i sheshit së bashku me nënkalimet dhe parkingun nëntokësor në qytetin e Malishevës" ishte kontraktuar më datën 12.01.2023, në vlerë 8,277,887€, ndërsa fondet e buxhetuara në Programin e Investimeve Publike (PIP) për tre vitet ishin 1,950,000€ (për vitin 2023 në vlerë 750,000€, për vitin 2024 në vlerë 600,000€ dhe për vitin 2025 në vlerë 600,000€). Përveç kësaj, kemi vërejtur se edhe para inicimit të procesit të prokurimit nuk ishte bërë	ketë fonde të mjaftueshme për realizimin e projekteve.			
--	--	--	---	--	--	--

zotimi fondeve të vitit aktual; • Projekti "Rregullimi i kolektorit kryesor të ujërave të zeza, faza e parë Bubël – Lubizhdë" ishte kontraktuar më datën 29.12.2022 në vlerë 1,369,527€, ndërsa fondet e buxhetuara në PIP për tre vitet ishin 1,775,005€ (për vitin 2023 në vlerë 150,000€, për vitin 2024 në vlerë 925,005€ dhe për vitin 2025 në vlerë 700,000€). Përveç kësaj, kemi vërejtur se edhe para inicimit të procesit të prokurimit nuk ishte bërë zotimi fondeve të vitit aktual; • Projekti "Ndërtimi i rrugëve, kanalizimit fekal, atmosferik dhe ndriçimit në qytetin e Malishevës" ishte kontraktuar më datën 31.07.2023, në vlerë 1,099,942€, ndërsa fondet e buxhetuara në PIP për tre vite ishin 590,000€ (për vitin 2023 në vlerë 70,000€, për vitin 2024 në vlerë 200,000€ dhe për vitin 2025 në vlerë 320,000€). Përveç kësaj,

		kemi vërejtur se edhe para inicimit të procesit të prokurimit nuk ishte bërë zotimi fondeve të vitit aktual; • Projekti "Rregullimi i parkut në fshatin Mirushë - faza e parë" ishte kontraktuar më datën 03.10.2023, në vlerë 298,125€, ndërsa fondet e buxhetuara në PIP për tre vite ishin 448,521€ (për vitin 2023 me vlere zero euro, për vitin 2024 në vlerë 198,521€ dhe për vitin 2025 në vlerë 250,000€). Përveç kësaj, kemi vërejtur se edhe para inicimit të procesit të prokurimit nuk ishte bërë zotimi fondeve të vitit aktual; dhe • Projekti "Asfaltimi i rrugës Nishor-Gërdall-Kërvasari" ishte kontraktuar me datën 31.10.2023, në vlerë 270,894€, ndërsa fondet e buxhetuara në PIP për tre vite ishin 670,000€ (për vitin 2023 në vlere 500,000€, për vitin 2024 në vlerë 50,000€ dhe për vitin 2025 në vlerë 120,000€). Përveç kësaj, kemi vërejtur				
--	--	---	--	--	--	--

		se edhe para inicimit të procesit të prokurimit nuk ishte bërë zotimi fondeve të vitit aktual. Kjo dukuri ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit pa pasur zotim të mjeteve.				
5	Çështja A3 Dobësi në menaxhimin e projekteve përmes platformës elektronike të e-prokurimit	Rregullorja nr.001/2022 për Prokurimin publik neni 70.24 pika (f) përcakton se menaxherët e kontratës “Të sigurojnë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik. Nga testimet e bëra, ka rezultuar se në gjashtë (6) raste, menaxhimi i kontratave dhe vlerësimi i performancës së kontraktuesve nuk është mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik (eprokurimi), si: • “Ndërtimi i sheshit dhe rrugës Ibrahim Mazreku në qytetin e Malishevës” në vlerë prej 2,659,844€;	Kryetari duhet të rishikoj shkaqet e mos përdorimit të sistemit e-prokurimi dhe të ndërmarrë masa shtesë të kontrollit për të siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet në sistemin elektronik të prokurimit publik.	Gjatë këtij viti kan filluar angazhime nga stafi mbikqyrës i projekteve duke u kyqur në sistemin elektronik të prokurimit në modulin e menaxhimit të kontratave .	Pjesërisht i zbatuar	

		• "Ndërtimi i sheshit së bashku me nënkalimet dhe parkingun nëntokësor në qytetin e Malishevës" në vlerë prej 8,277,887€; • "Ndërtimi i rrugës së Habib Berisha, Mulla Sejdiu dhe rregullimi i parterit të palestra e sportit Habib Zogaj në Malishevë" në vlerë prej 1,369,527€; • "Renovimi dhe mirëmbajtja verore-dimërore e rrugëve dhe lumenjve në tërë territorin e komunës së Malishevës" sipas çmimit për njësi 1,102€; • "Ndërtimi i objektit të shkollës fillore dhe sallës së edukatës fizike në fshatin Turjakë në vlerë prej 991,730€; dhe • "Ndërtimi i kanalizimeve nëpër fshatrat e komunës së Malishevës" në katër loto" në vlerë prej 187,420€. Kjo ka ndodhur si pasojë e anashkalimit të përdorimit të procedurës së kërkuar nga zyrtarët përgjegjës.				
--	--	---	--	--	--	--

6	Çështja A4 Vonesa në mbylljen e avanceve/par adhënie për udhëtime zyrtare	Rregullorja nr.06/2023 për kompensimin e udhëtimeve zyrtare dhe shpenzimeve të përfaqësimit, neni 9 pika 1 përcakton se: kërkesa për kompensim dhe shpenzime të vogla së bashku me të gjitha dëshmitë për shpenzimet financiare i dorëzohet njësisë përkatëse për buxhet dhe financa brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë pune, nga dita e përfundimit të udhëtimit zyrtar. Po ashtu, neni 10 pika 4 parasheh se: në rast kur zyrtari nuk kthen shumën, ajo do të ndalohet sipas sistemit të pagave. Në gjashtë (6) raste të testuara avancet e dhëna për udhëtime zyrtare në vlerë 5,503€ nuk ishin mbyllur brenda afatit ligjor prej 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi zyrtar. Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i mos ndërmarrjes së veprimeve ligjore nga menaxhmenti i komunës ndaj zyrtarëve përfitues për kthimin e mjeteve.	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha avancet për udhëtime zyrtare duhet të arsyetohen dhe shumat e pa shpenzuara të kthehen në afat prej 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi. Në të kundërtën, duhet të sigurojë marrjen e veprimeve ligjore ndaj personave përgjegjës të cilët nuk i kanë arsyetuar ose kthyer mjetet e pranuar-avancet.	Kemi ende avanse të pa mbyllura të udhëtimeve zyrtare nga viti i kaluar.	I pa zbatuar	
---	---	--	---	--	--------------	--

7	Çështja A5 Zotimi i mjeteve dhe urdhër blerjet jo sipas rregullave financiare	Rregulla nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, neni 22 përcakton, hapat që fillimisht duhet të procedohet zotimi i mjeteve, lëshohet urdhër blerja dhe pas pranimi të blerjeve bëhet raporti i pranimi, pranohet fatura dhe në fund procedohet për pagesë nga Thesari. Gjatë testimeve, kemi identifikuar se në 35 raste për investime kapitale, në vlerë të pagesave 2,348,295€ dhe në shtatë (7) raste mallra dhe shërbime në vlerë prej 186,757€, zotimi i mjeteve dhe urdhër blerjet ishin bërë pas pranimi të mallit apo shërbimit/punëve dhe pranimi të faturës. Kjo dukuri ka ndodhur për faktin që nuk janë zbatuar rregullat ligjore për shpenzimin e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës, si dhe nga mos planifikim i duhur i rrjedhës se parasë.	Kryetari duhet të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet puna/shërbimi dhe të kryhet pagesa.		I pa zbatuar	
---	--	--	---	--	--------------	--

8	Çështja B3 Pagesa të projekteve nga buxheti i projekteve tjera	Ligji nr. 08/L-193 Ndarjet buxhetore për vitin 2023, neni 16 pika 11 përcakton se; Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese si rezultat i transfereve dhe/ose rialokimeve, të prezantuara në tabelën 4.2., duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal, Rialokimet duhet të kryhen në përputhje me procedurat dhe kriteret e parapara me UA MF. nr. 05/2019 për procedurat e transferit dhe rialokimit të ndarjeve buxhetore. Në dy (2) raste për projekte kapitale komuna ka përdorë fondet nga një projekt në tjetrin për të cilat nuk ishin planifikuar këto fonde. Rastet e tilla ishin si në vijim : • Nga fondet e ndara për projektin "Renovimi i QKMF-ve në fshatrat: Bellanicë, Panorc dhe Drenoc" janë paguar për blerjen e pajisjeve	Kryetari duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme që projektet e aprovuara të realizohen sipas planifikimit. Nëse paraqitet nevoja për ridestitim të fondeve të projekteve, kjo të realizohet përmes procedurave të përcaktuar me rialokim në pajtim me Ligjin mbi ndarjet buxhetore.	Kemi raste të rialokimit të mjeteve nga një kod i projektit në projektin tjetër për investime kapitale.	I pa zbatuar	
---	---	--	--	---	--------------	--

		mjekësore në vlerë 40,000€; dhe • Nga fondet e ndara për projektin "Ndërtimi i palestrës sportive në shkollën e mesme "Lasgush Poradeci" janë paguar për projektin "Ndërtimi i objekteve arsimore" në vlerë 19,999€. Ri-alokimi i fondëve buxhetore nga një projekt kapital në një tjetër është kryer pa aprovimin e kuvendit komunal. Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të duhur të kontroleve brendshme, të hyrjeve në kontrata publike pa mjete të mjaftueshme për projekte të caktuara dhe shpenzimi i fondeve në projektet e caktuara me rastin e ekzekutimit të pagesave përmes vendimeve gjyqësore.				
9	Çështja B4 Vonesa në pagesën e faturave	Ligji nr. 03 /L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 39.1 përcakton që secila faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë të mallrave dhe shërbimeve të paguhet brenda 30	Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare të kryhen në kohë	Nuk kemi ndyshime të theksuara të gjendjës në raport me vitin e kaluar lidhur me vonesat në	I pa zbatuar	

		ditëve kalendarike pas marrjes së faturës. Në tre (3) raste, faturat në vlerë totale prej 82,738€ që kanë të bëjnë me mallra dhe shërbimetë paraqitura në PVF, përfaqësojnë fatura të papaguara për më shumë se 30 ditë, me vonesë nga 85 ditë deri në 178 ditë. Shkak i mos pagesës me kohë të detyrimeve, ishte planifikim jo i mirë i buxhetit dhe iniciimi i procedurave të shpenzimeve pa mjete në dispozicion, si dhe mungesa e komunikimit në mes të zyrtarëve përgjegjës.	dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.	pagimin e faturave.		
10	Çështja B5 Mungesë e projektit ekzekutiv si pjesë e specifikave teknike	LPP neni 28.10 kërkon që: Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës të punëve të kërkuara. Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutiv. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për	Kryetari duhet të rishikoj kontrollet e vendosura në procesin e planifikimit dhe iniciimit të projekteve investuese dhe të siguroj se gjatë përgatitjes së specifikave teknike për projekte investuese të kenë të përgatitur edhe	Menaxhmenti ka bërë përpjekje të lidhë kontrata përmes procedurave të prokurimit për hartimin e projekteve me OE, por për shkak të ankesave dhe vonesave nga OSHP-ja jemi detyruar të inicojmë projekte	Pjeserisht i zbatuar	

		hartimin e Projektit Ekzekutiv, dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t'i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit. Në projektin "Rregullimi i parkut në Fshatin Mirushë", tenderi ishte shpallur pa përfshirë projektin ekzekutiv në specifikat teknike të dosjes së tenderit. Vlera e kontratës ishte 298,125€. Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme në planifikimin dhe inicimin për projektin e lartcekur.	projektin ekzekutiv, dhe të njëjtin t'ia bashkëngjisnin dosjes se tenderit me rastin e publikimit të saj.	për te mos patur deshtim te tyre .		
11	Çështja A6 Logjistika pa depo të furnizimit	Rregullorja s nr.02/2013 – për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 8 paragrafi 2 përcakton se: Pranimi i pasurive jo financiare në depo duhet të bëhet në	Kryetari duhet të sigurojë ndërmarrjen e hapave konkrete për gjetjen në një zgjidhje për caktimin e një depo	Menaxhmenti i lartë ka ndermarr veprime duke caktuar tre zyrtar të deposë të cilet kan kryer trajnimet e	I zbatuar	

		bazë të fletëpranimit përkatës të nënshkruar nga Zyrtari i Pranimit/Logjistikës, pas verifikimit të sasisë, vlerës dhe cilësisë që i referohen kushteve me kontratë apo të urdhër blerjes. Furnizimet me material zyre nuk evidentohen në depo, sepse komuna ende nuk ka zgjidhur problemin e depos. Materiali për zyre shprendahet drejtpërdrejt nga furnizuesi tek drejtorit përkatës sipas nevojës. Kjo ka ndodhur nga mos gatishmëria e menaxhmentit për të zgjidhur problemin e depos.	ku furnizimet me material zyre pranohen dhe vendosen në depo duke regjistruar hyrjen dhe daljen e tij. Kjo do të ndihmojë që zyrtari përgjegjës i logjistikës do t'i regjistrojë hyrjet dhe daljet e pasurive jo financiare duke mbajtur shënime të sakta mbi rezervat e pasurive jo financiare të komunës.	nevojshme dhe jemi në proces të funksionalizimit të tyre.		
12	Çështja A7 Mos mbyllja e investimeve në vijim dhe mos inventarizimi i pasurive	Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, neni 11, paragrafi 3 përcakton që; Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do	Kryetari duhet të ndërmarr veprimet e nevojshme në forcimin e kontroleve të brendshme për korrigjimin e regjistrit të pasurive, dhe në veçanti duke i verifikuar dhe korrigjuar vlerat e pasurive me	Zyrtari i pasurisë është në proces të mbylljes së zerave të investimeve në vijim. Ka fundi i vitit në vijim, kryetari do të caktoj edhe komisionin për inventarizim të pasurisë jofinanciare.	Pjeserisht i zbatuar	

		të zbatohet edhe zhvlerësimi. Po ashtu, neni 19, i kësaj rregullore përcakton se: Komisioni për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare do të jetë organ i përkohshëm i formuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ i organizatës buxhetore. • Në kuadër të kodit ekonomik "32500 Investimet në vijim" kemi gjetur se nuk janë mbyllur dy projektet të cilat janë finalizuar nga viti 2018 në vlerë totale prej 56,343€. Për më tepër, nuk mund të kalkulohet zhvlerësimi i këtyre pasurive, pasi ato ende janë të regjistruara si investime në vijim; si dhe • Kryetari nuk e ka formuar komisionin e inventarizimit për kryerjen e procesit të inventarizimit të pasurisë jo financiare. Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së mjaftueshme të	statutin "Investime në vijim" dhe nëse jetëgjatësia e përdorimit të pasurive është ajo e përcaktuar me rregullore dhe që vlera e pasurive të prezantohet e saktë. Po ashtu, duhet të sigurojë formimin e komisionit që procesi i inventarizimit kryhet me kohë para hartimit të PVF-ve.			
--	--	---	--	--	--	--

		kontrolleve të brendshme ndaj menaxhimit të pasurive jo financiare në vitet e kaluara, si dhe mos kryrja e procesit të inventarizimit të pasurisë brenda afatit të paraparë ligjor rrit rrezikun për informata të mangëta mbi gjendjen e pasurisë që posedon komuna.				
13	Çështja B6 Dobësitë në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme	Ligji për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr. 06/L 005, neni 23, përcakton se : Pagesa e detyrimeve tatimore dhe shpërndarja e pagesave paragrafi 1, Për vitin tatimor 2019 dhe vitet tatimore në vijim, tatimi dhe gjoba, nëse ka të këtillë, paguhen me dy këste të barabarta, deri më 30 prill dhe 30 shtator të vitit tatimor. Llogaritë e arkëtueshme për vitin 2023 ishin gjithsej 2,968,766€, prej të cilave 1,737,589€ apo 59% ishin për tatimin në pronë. Komuna vetëm kishte paralajmëruar tatimpaguesit për vonesat e tyre, por nuk kishte pasur asnjë rezultat në arkëtimin e këtyre borxheve. Më	Kryetari duhet të sigurojë se mbledhja e Ll.A nga tatimi në pronë bëhet sipas kërkesave dhe mënyrave të përcaktuara ligjore. Ndërsa për Ll.A nga taksa në biznes dhe të qirave, të shqyrtohen të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore dhe deri përmes mjeteve juridike me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve.	Menaxhmenti komunal ka ndermarr veprime të nevojshme duke filluar procedurat e inkasimit të detyrueshem të obligimeve tatimore permes bllokimit të llogarive për borgjlinjët e mëdhenjë.	I zbatuar	

		tutje komuna nuk kishte marrë veprime tjera lidhur me arkëtimin e borxheve. Komuna nuk kishte ndërmarr veprime për mbledhjen e këtyre borxheve duke pas parasysh kërkesën për mos zbatimin e masave si pezullimin e shërbimeve komunale dhe propozimin për përmbarim.				
--	--	--	--	--	--	--